



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 12
Ndërtesa e Kuvendit, salla N -10
Prishtinë, më 29 korrik 2020, në orën 12:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit: Albena Reshitaj, Haxhi Avdyli, Labinotë Demi-Murtezi, Fitim Haziri, Ekrem Hyseni, Uran Ismaili, dhe Bekim Haxhiu.

Munguan : Fitim Uka, Mirlinda Sopi – Krasniqi dhe Milosh Peroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Jeta Statovci dhe Artan Murati –KRRK, Valbona Zekaj–D+, Salih Hoxha-GP/LV dhe Festim Bytyçi– KSHMS.

Stafi Mbështetës: Shprese Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë i fushës/analist.

Mbledhjen e kryesoi, Albena Reshitaj, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.6.2020 dhe 25.6.2020;
- 3.Shqyrtimi në parim i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës;
- 4.Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.6.2020 dhe 25.6.2020;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datën: 19.6.2020 dhe 25.6.2020, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës;

Albena Reshitaj, kryetare e Komisionit, tha se ka më shumë se një muaj që nuk kemi mbajtur mbledhje të Komisionit, për shkak që tani dihen, pasi që një numër i deputetëve dhe stafit kanë rezultuar pozitiv më Covid-19, por që tani pjesa më madhe janë shëruar dhe besoj që do të fillojmë me punët që e presin Komisionin. Reshitaj theksoi së numri i të infektuarve më Covid -19 është i madh dhe duhet urgjentisht të merren masa parandaluese. Është e mirë që është themeluar Bordi Këshillues për Covid-19, pasi që është e domosdoshme që ky bord të jetë këshillëdhënës që do t'i ndihmojë IKSHPK-së dhe MSH-së. Ajo kërkoi që të rritet monitorimi dhe përgjegjësia ndaj Ministrisë së Shëndetësisë, në lidhje me koordinimin e përbashkët të Inspektorateve (sanitar, të tregut, dhe të punës). Gjithashtu, kjo të bëhet edhe më koordinimi me inspektoratet komunale që duhet me vendosmëri dhe përkushtim të ushtrojnë kontrollin për respektimin e masave dhe rekomandimeve të lëshuara nga IKSHPK-ja, respektivisht zbatimin e vendimeve të Qeverisë.

Ndërsa, sa i përket Shqyrtimit në parim të Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, kjo nismë ligjore është propozuar nga kryetarja e Kuvendit znj. Vjosa Osmani, dhe është obligim i Komisionit ta shqyrtojë pasi që njëkohësisht komisioni është ngarkuar edhe nga Kryesia Kuvendi për ta bërë shqyrtimin e projektligjit, andaj dispozitat e këtij projektligji duhet të jenë primare në zbatim të ligjit dhe në parim e përkrahu Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës.

Haxhi Avdyli, tha se ky projektligji ka ardhur si nevojë e kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, që të hartohet një ligj për pandemi, ku do t'i mundësojë Ministrisë së Shëndetësisë, që të bëjë disa kufizime të lehta dhe të domosdoshme të lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe ka qenë e paarsyeshme që ky projektligj nuk është përkrahu nga Qeveria. Ky projektligj ka për qëllim që të krijojë një hapësirë juridike, duke krijuar mekanizëm ligjor e posaçërisht për Ministrinë e Shëndetësisë t'i mundësojë kufizime të lehta lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe miratimi e këtij ligji i shërben më së shumti MSH-së dhe Qeverisë. Avdyli theksoi së është nënshkruar si deputet për këtë nismë ligjore dhe projektligji është përpiluar nga ekspertët më të mirë që kemi dhe kërkoi që në seancën e radhës të procedohet ky projektligj, pasi që tha, jemi të vonuar në këtë drejtim, prandaj dhe përkrahja e të gjitha grupeve parlamentare tregon një pjekuri që duhet të votohet dhe ta dërgojmë për miratimi në Kuvend në lexim të parë. Ndërsa, ndërmjet dy leximeve mund t'i bëjmë amendamentet dhe të shërbejnë që ky projektligj të jetë më komplementar, më i plotësuar, pasi jemi vonuar shumë, prandaj ky projektligj i shërben më së shumti Qeverisë dhe MSH-së, për punën e tyre të mëtutjeshme dhe nëse ky ligj shërben që pandemia të bie, atëherë e kemi bërë një punë shumë të madhe.

Labinotë Demi-Murtezi, tha se Projektligji për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës është më i nevojshmi për momentin në vendin tonë dhe më në fund po shkon drejt amendamentimit dhe plotësimit, pas 4 muajsh, prejse ka filluar si iniciativë dhe është më se i arsyeshëm, pasi që edhe në mbledhjen e kaluar e kemi dhënë mendimin se duhet të ketë ligj për parandalimin e Pandemisë Covid -19. Për zbatimin e këtij ligji duhet të rritet numri i inspektorëve, siç dihet deri më tani kemi pasur mungesë të inspektorëve për ta mbikëqyrur zbatimin

e vendimeve, andaj me miratimin e ligjit më së shumti do t'i ndihmojmë stafit shëndetësor dhe Grupi Parlamentar i LVV-së i jep mbështetje miratimit të Projektligjit.

Uran Ismaili, tha se masat në luftimin e pandemisë, duhet të jenë më rigorozë, në mënyrë që ta tejkalojmë këtë pandemi dhe ky projektligj ka ardhur si kërkesë e Gjykatës Kushtetuese, ku ka thënë që mund merret një vendim nga institucionet përkatëse për miratimi të ligjit për parandalimi të Pandemisë me Covid -19. Ai potencoi së Gjykata Kushtetuese ka qenë koshiente në këtë drejtim, por është e rëndësishme që ne ta ruajmë rendin demokratik dhe Grupi Parlamentar i PDK-së edhe si deputet jemi për dhe kemi qenë për këtij ligji, pasi që 5 muaj nuk po mundet të blihet një pajisje sepse IKSHPK-ja thotë se MSH-ja duhet ta blejë, dhe nëse nuk reagojmë shpejt, virusi nuk ndalet. Ai theksoi se ne duhet që brenda këtij projektligji ta lejojmë një nen që të punësohen në këtë kohë disa punëtorë shëndetësorë dhe e dimë se kemi shumë mjek dhe infermierë të papunë. Po ashtu, duhet ta shohim se a kemi mundësi që brenda këtij projektligji t'i ndihmojmë komunat, prandaj ky projektligj nuk duhet të ndalet vetëm me kufizime juridiko- ligjore por të jetë edhe në shërbim të sistemit dhe stafit shëndetësorë dhe nëse është duke ndodhur një zbrazësi, cilët janë hapat që duhet t'i ndërmerret Qeveria dhe Ministra e Shëndetësisë, për të plotësuar atë zbrazësi sepse në të kundërtën, ne po sillemi në formë neutrale që zgjidhja do vijë vetvetiu dhe ajo nuk vjen vetvetiu, por ta rregullojmë ligjin në atë mënyrë, që mos të ketë hapësira për mosveprim dhe mos ta bëjmë sa për sy e faqe, vetëm sa për të thënë se po i japim një autorizim ministrit me ndal një lagje atje apo këtu, atë po se po, por të paktën t'i japim edhe sistemit shëndetësor një mbështetje që edhe ata të dalin përtej asaj që kanë sot dhe përtej autorizimeve që i kanë sot.

Fitim Haziri, tha se ky projektligj nuk është i përkryer dhe ka nevojë që ta amendatojmë gjatë dy leximeve në parim dhe jam për miratimin e tij. Ai theksoi se masat të cilat janë marrë nga Qeveria tanishme po vërehet që edhe aty kemi shkelje të Kushtetutës, për të mos u përsëritur shkelja e Kushtetutës, është e domosdoshme që të krijohet bazë ligjore që nuk do përsëriten veprime të tilla që përmes kufizimeve të lehta dhe të domosdoshme të lirive dhe të drejtave të njeriut për një përudhë të caktuar, ndërsa bie lakorja pandemisë ta kemi një bazë ligjore. Andaj kjo bazë ligjore që ka aritur për shqyrtim, nuk është i përkryer dhe ka nevojë për përmirësime dhe është mundësia jonë që në momentin që vjen dhe trajtohet përsëri në komision, atëherë t'i shqyrtojmë ato më të mirat dhe t'i propozojmë që këto çështje të rregullohen.

Bekim Haxhiu, tha që duke e njohur legjislacionin e Ministrisë së Shëndetësisë, ky projektligj merret vetëm më një fushë të caktuar, vetëm me kohën e kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe nuk ka masa ndëshkuese. Tek qëllimi i Projektligjit është cekur vetëm kufizimi, ndërsa tek Ligji që është në fuqi për Parandalimin dhe Luftimin Sëmundjeve Ngjitëse, qëllimi është se me këtë ligj përcaktohen sëmundjet ngjitëse si dhe rregullohen aktivitetet për zbulimin në kohë, evidencimin e shfaqjes, parandalimin, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre. Ai theksoi se si iniciativë është në rregull, ndërsa si materie nuk ka përmbajtje dhe neve na duhet ta bëjmë çka është veprim penal dhe parandalues dhe fjalja përmes kufizimeve të lehta të lirive dhe të drejtave të njeriut, është problem ta përcaktojmë, çka dëshirojmë të arrijmë, andaj luftimi i Pandemisë Covid-19 duhet të përcaktohet si materie më përmbajtjesore. Kërkoj që brenda javës të amendamentohet Projektligji për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Haxhiu propozoi që mbledhjet e radhës së komisionit të mbahen online më platformën ZOOM.

Ekrem Hyseni, tha së është për Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, por kërkoj që mos të ndalemi vetëm në aspektin juridik të rregullimit të këtij projektligji.

Hyseni propozoi që të plotësohet më disa ndryshime projektligji siç janë: stimulimi i veçantë për personelin shëndetësorë që merren drejtpërdrejt me trajtimin e pacientëve që janë të infektuar me Covid-19; Komisioni ta bëjë një propozim, ku do të ketë dallim në mes të profesionistëve shëndetësorë që merren drejtpërdrejt me pandeminë, duke i veçuar mjekët e kujdesit intensiv, infektologët, pulmologët, Klinikën e Neurologjisë dhe stafit tjetër mbështetës që të stimulohen në mënyrë të ndarë prej të tjerëve, që merren direkt me të sëmurët me virus dhe kompensimi të ndryshojë jo siç ka qenë për 2 muaj i njëjti për të gjithë, pasi që dihet se jo i gjithë stafi shëndetësorë merret drejtpërdrejt me pandeminë Covid -19.

Fikrim Damka, tha që në parim pajtohet që të miratohet Projektligji për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, por që gjatë dy leximeve duhet të jetë më i gjerë dhe me përmbajtje. Damka propozoi që të përshpejtohen procedurat për miratim para së të mbyllet sesion pranveror.

Albena Reshitaj, potencoi se po shihet një gatishmëri dhe vullnet i të gjithëve për të kontribuar që ky projektligj të jetë sa më i plotë. Konsideroj që Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e përkrah në parim Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës.

Reshitaj kërkoi që ti dërgohet një shkresë Kryesisë së Kuvendit që të ketë shmangie nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, në mënyrë që ky projektligj të miratohet me procedurë të shpejtë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligji për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës;

2. I Rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës;

3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, Albena Reshitaj, kryetare e Komisionit.

4. Të ndryshme.

Fitim Hazir, ne emër të Grupit Parlamentarë të LVV-së kërkoi përsëri që të vijë në raportim për gjendjen e menaxhimit me Covid-19, Armend Zemaj, ministër i Shëndetësisë, dhe Valbon Krasniqi, ushtruesi i detyrës së drejtorit të SHSKUK-së.

Albena Reshitaj, tha se do ta ripërsërisin kërkesën pas rifillimit të punës së Komisionit, duke qenë se më herët ka qenë e pamundur të mbahet mbledhja për shkak të shëndetit të anëtarëve dhe kryetares së Komisionit.

Komisioni përkrahu propozimin e z. Haziri.

Bekim Haxhiu, kërkoi nga anëtarët e komisionit që në seancë plenare ta përkrahin në propozimet e tij, të cilat i ka dhënë në kuadër të amendamenteve për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për buxhetin e vitit 2020, në lexim të dytë. Duke thënë se në këto propozime është përfshirë rritja e

pagave për profesionistët shëndetësorë, policët dhe kategoritë tjera që janë duke u përballur me Pandeminë Covid-19.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albena Reshitaj